



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

ADGJTHFR.nr.5/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese Q.B., me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj A.B., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 27.06.2024, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj A.B., e paraqitur nga pala ankuese Q.B., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

A r s y e t i m i

Ankuesi Q.B. me datë 12.06.2024 përmes e-mailit dërguar në adresën të Gjykatës Themelore në Ferizaj ka ushtruar ankesë të titulluar “Ankesë për Sistemin e Drejtësisë”, të cilën ankesë e ka drejtuar edhe në adresa zyrtare tjera të institucioneve shtetërore. I njëjti në formularin e ankesës të plotësuar ka paraqitur se subjekti i ankesës është gjyqtari A.B. dhe se informatat lidhur me rastin përkatës rrjedhin nga numri i rastit C.nr.483/16. I ka sqaruar pretendimet e tija ankimore ndaj gjyqtarit A.B., duke theksuar se i njëjti është bërë viktimë e një akuze të pa bazë me numër të rastit 2018:01265, ku më është shitur një lokal në Ferizaj dhe pastaj jam akuzuar për fajde ku jam shpallur i pafajshëm. Para se ta hedh akuzën Prokuroria Themelore në Ferizaj me datë 17.07.2017

me numër PP.I.nr.88/2016, personi që më akuzuar padrejtësisht në vitin 2016 ka paraqitur kërkesë për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil. Gjyqtari A.B. ja mundëson A.R. që ma ka shitur lokalin dhe që posedoj të gjitha dokumentet dhe që hedh akuza ndaj meje padrejtësisht dhe të pabazuara, ky person shfrytëzonte lokalin praj fillimit të gjykimit deri sot ku kaluan mbi dhjetë vite. Gjyqtari A.B. më ka pyetur atëherë nëse jam kundër nëse e bllokoj lokalin që unë mos mund ta shes deri sa të merremi vesh se çka është problemi, dhe unë nuk kam qenë kundër sepse nuk e kam blerë lokalin për ta shitur. Por gjyqtari A.B., si po duket ka marr një vendim që ja mundëson A.R. ta shfrytëzoj lokalin deri sot dhe të marr qira për këtë lokal. Unë disa herë jam ankuar në polici dhe ashtu në Gjykatën Themelore në Ferizaj por skam marr kurrfarë përgjigje për këtë rast. Tash me vendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës përfundimisht lirohem nga të gjitha akuzat që janë bërë kundër meje të pa baza, e cila procedurë vazhdon deri më tani gati dhjetë vite dhe gjatë gjithë kësaj kohe personi që më akuzonte personi që më akuzonte shfrytëzonte qiranë e lokalit, kjo për shkak se gjyqtari A.B. që motivi i këtij vendim është i paditur, duke kërkuar që ky rast të përfundoj dhe te hetohet veprimi dhe motivi i gjyqtarit A.B. që më ka bërë këtë padrejtësi dhe dëmin e shkaktuar që dhjetë vite.

Ankuesi gjithashtu ankesën e ka paraqitur edhe ndaj prokurorisë Themelore në Ferizaj lidhur me ngritjen e aktakuzës ndaj tij si dhe ndaj gjyqtari M.K, në atë kohë gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, mirëpo tani gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Duke e përshkruar ecurinë e procesit cili sipas ankuesit është filluar nga prokuroria dhe atë; Me datë 01.03.2016, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.483/16, me datë 23.02.2017 Aktvendimi i Gjykatës Themelore Ferizaj, Ac.nr.793/2017, me datë 03.05.2017 Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.183/16. Aktakuza e Prokurorisë Themelore Ferizaj datë 17.07.2017 me numër PP.I.nr.88/2016 i akuzuar Q.B. për veprën penale fajde ne neni 343 par.3 të KPRK-së dhe veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së. Me datë 17.07.2017 Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj P.nr.1130/15 i datës 24.11.2017 është shpallur fajtor (A.R.) për veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së. me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ferizaj PKR.nr.98/17 të datës 28.09.2018, gjyqtari M.K, ka shpall fajtor (të akuzuarin Q.B.) për veprën penale fajde nga neni 343 par.3 të KPRK-së, ndërsa për veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së refuzohet akuza. Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.295/19 datë 14.08.2019 anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj PKR.nr.98/17 të datës 28.09.2018 dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Me Aktgjykimin PKR.nr.116/19 datë

01.03.2022 Gjykata Themelore në Ferizaj e liron nga akuza për veprën penale fajde nga neni 343 par.1 të KPRK-së. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.189/22 të datës 22.07.2022 anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj PKR.nr.116/19 të datës 01.03.2022 dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktgjykimin 2018:012650 datë 11.05.20223 e liron të akuzuarin Q.B. nga akuza për veprën penale fajde nga neni 343 par.1 të KPRK-së, me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës 2018:01265 datë 10.11.2023 Gjykata Apelit në Prishtinë refuzon ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe vërteton Aktgjykimin 2018:012650 të datës 11.05.2023 të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Ankuesi si prova i ka bashkangjitur kopje të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda 2018:012650 datës 10.05.2023 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës 2018:012650 (PAKR.nr.367/26) datës 24.08.2023.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Ferizaj konform dispozitave ligjore Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka trajtuar ankesën e ankuesit Q.B. vetëm në raport me subjektin e hetimit disiplinor gjyqtarin e Gjykatës Themelore Ferizaj A.B., pasi që sa i përket gjyqtarit të cekur në ankesë M.K i njëjti tani më është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku ankuesi gjithashtu të njëjtën ankesë që është pranuar në e-mailin zyrtar të Gjykatës Themelore në Ferizaj, ankuesi e ka dërguar autoritetit kompetent – email zyrtar të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe gjithashtu edhe në adresë të Këshillit Prokurorial të Kosovës sa i përket ankesës ndaj Prokurorisë.

Gjyqtari A.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndaj të cilit pala ankuese ka paraqitur ankesën, në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se sa i përket pretendimeve të palës ankuese, unë kam vendosur bazuar në provat të cilat kanë qenë në shkresat e lëndës, kam vlerësuar se padinë e paditësit A.R. nga Ferizaj, e paraqitur ndaj Q.B. nga fshati ..., komuna Viti me objekt kontesti zgjidhjen e kontratës së shitblerjes dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në pikën I të dispozitivit të Aktvendimit C.nr.483/16 (C.nr.2019:091785) ta ndërpresë procedurë në përputhje me dispozitat ligjore bazuar në nenin 278.1 të LPK-së, pasi që kam vlerësuar se si çështje paraprake është dashur të përfundoj procedura penale me aktgjykim të plotfuqishëm. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit palët janë udhëzuar se pas plotësimit të kushteve ligjore mund të kërkojnë vazhdimin e procedurës kontestimore. Andaj, vlerësoj se asnjë

e drejtë ligjore apo kushtetuese nuk i është cenuar palës së paditur Q.B. me Aktvendimin C.nr.483/16 (C.nr.2019:091785) mbi ndërprerjen e procedurës ashtu siç pretendon, pasi që vendimin e lartcekur është i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Dhe bazuar në rrethanat e theksuara konsideroj se nuk ka bazë për inicim të procedurës disiplinore.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit A.B. si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese, dhe shkresave të lëndës C.nr.483/16 ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtari A.B..

Nga shkresat e lëndës C.nr.483/16 konstatohet se Gjykata Themelore në Ferizaj me datë 01.07.2016 ka pranuar padinë e paraqitur nga paditësi A.R., nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat I.Q., kundër të paditurit Q.B. nga fshati ..., komuna Viti, me bazë kontesti prishja e kontratës për shitblerjen e palujtshmërisë me kusht, si dhe caktimin e masës së sigurisë në ngastrën kastastrale të cekur si në padi.

Gjyqtari A.B., duke vepruar sipas çështjes juridike përkatësisht kërkesës për caktimin e masës së sigurisë, me datë 01.08.2016 pas mbajtës së seancës ka marr Aktvendimin C.nr.483/16 datë 01.08.2016 ku edhe ka caktuar masën e sigurisë dhe i ka ndaluar të paditurit Q.B. të ndërmarrë çfarëdo veprimi-tjetërsimi apo futje në hipotek palujtshmerinë objekt i këtij kontesti, deri në përfundim të procedurës sipas lëndës C.nr.483/16.

Kundër këtij aktvendimit C.nr.483/16 datë 01.08.2016 mbi caktimin e masës së sigurisë, i padituri Q.B. përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar av.K.A. ka paraqitur ankesë.

Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktvendimin Ac.nr.73/2017 datë 23.02.2017 ka pranuar ankesën e të paditurit dhe ka prishur Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.483/2016 i datës 01.08.2016, ashtu që lënda është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Gjyqtari A.B. me Aktvendimin C.nr.483/16 datë 03.05.2017 ka detyruar paditësin A.R. që në emër të garancionit të deponoj shumën e cekur në këtë aktvendim, në të kundërtën gjykata propozimin për masën e sigurisë do ta refuzon si të pabazuar.

Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktvendimin Ac.nr.3139/17 datë 27.07.2017 ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e të paditurit Q.B. të paraqitur kundër aktvendimit C.nr.483/2016 datë 03.05.2017.

Gjyqtari A.B. me aktvendimin C.nr.483/16 të datës 29.08.2022 ka ndërprerë procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit A.R. e paraqitur kundër të paditurit Q.B. për arsye se si çështje paraprake duhet të përfundohet procedura penale sipas aktgjykimit PKR.nr.116/19 datë 21.01.2022 me vendim të formës së prerë.

Sipas shkresave të bashkangjitura nga ankuesi, por edhe ato që gjenden në shkresa të lëndës konstatohet se Q.B. sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj 2018:012650 datë 10.05.2023 është liruar nga akuza për veprën penale fajdeja ne neni 343 par.3 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.88/16 datë 17.07.2017, i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës sipas aktgjykimit PAKR.nr.367/23 datë 24.08.2023.

Pretendimi i palës ankuese se në rastin konkret me vendimet që janë marrë në procedurë civile nga gjyqtari A.B. ka pasur shkelje dhe sipas ankuesit është përgjegjës për çështjet civile të zhvilluara në atë kohë dhe se për shkak të vendimit të gjyqtari A.B. i njëjti nuk ka mundur as të hyjë e as ta përdorë lokalitetin dhe arsyeve të përshkruara si më lartë, janë pretendime të pa bazuara dhe supozuese dhe nuk ka specifikuar qartë ndonjë shkelje apo sjellje konkrete të karakterit disiplinor nga ana e gjyqtarit, por vetëm ka theksuar se konsideron se në rastin në fjalë si pasojë e vendimeve të gjyqtarit A.B. i njëjti është dëmtuar shkak i gjyqtarit, pra vetëm në mënyrë gjenerale pa u specifikuar ndonjë shkelje apo dyshim për shkelje disiplinore.

Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e ushtruesit të ankesës për shkelje disiplinore, sepse gjyqtari i rastit ka ndërmarr veprime procedurale në drejtim të zgjidhjes së lëndës. Po ashtu, vlerëson se veprimet procedurale nga gjyqtari A.B. në çështjen kontestimore C.nr.483/16, janë veprime që janë ndërmarrë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive si gjyqtar, në pajtim me ligjin. Po ashtu, vlerëson se gjyqtarët në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në punën e tyre janë të pavarur dhe vendosin në bazë të provave dhe fakteve që gjenden në shkresat e lëndës dhe sipas ligjeve në fuqi,

përkatësisht gjyqtari i çështjes në rastin konkret ka vendosur në bazë të nenit 278.1 dhe nenit 8.1 të LPK-së. Po ashtu të gjitha vendimet e gjyqtarit të marra gjatë kësaj procedure, kanë pasur të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike në instancën e gjykatës më të lartë, pa ju cenuar e drejta për ankesë, andaj pretendimet e parashtruesit të ankesës për shkelje të karakterit disiplinor edhe pse nuk janë specifikuar dhe potencuar të njëjtat, janë të pabazuara.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore ndaj gjyqtari A.B., andaj si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

AD/GJTHFR.5/2024

27 qershor 2024

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

Q.B. - Parashtrues i ankesës

A.B. - Gjyqtar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës